



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 4081/Prot.

Tiranë, më 06.12. 2021

VENDIM

Nr. 47, datë 25.11. 2021

***“Për hapjen e programit të studimit Bachelor në “Përkthim Dygjuhësh - Gjuhë Ruse dhe Gjuhë e Dytë Sllave (Ukrainase, Maqedonase, Bullgare)”, të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për vitin akademik 2022-2023”***

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1, neni 38, pika 1, gërma “dh”; Udhëzimin e MASR-së Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”. Kreu IV, gërma “A”, i ndryshuar, Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2, i ndryshuar dhe Statutin e Universitetit të Tiranës neni 31, gërmat f), j) dhe cc), si dhe në propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja me shkresën Nr. 987 Prot., datë 23.11.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 25.11.2021:

VENDOSI:

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimit “Bachelor” në “Përkthim Dygjuhësh - Gjuhë Ruse dhe Gjuhë e Dytë Sllave (Ukrainase, Maqedonase, Bullgare)”, të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, sipas dokumentacionit bashkëngjitur, për vitin akademik 2022-2023.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Përkthim Dygjuhësh - Gjuhë Ruse dhe Gjuhë e Dytë Sllave (Ukrainase, Maqedonase, Bullgare)”, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.
3. Dokumentacioni përkatës të përcillet për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
4. Dokumentacioni përkatës të përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

  
KRYETARI  
PROF. DR. ARTAN HOXHA  
